

Me një urdhër të zyrës së shëndetit publik Lichtenberg nuk duhet të prisni.

Unë jam i detyruar të futem në karantinë, nëse:

Jam testuar pozitiv për SARS-COVID-2.

Jam person kontakti I në përputhje me kriteret e RKI.

Kam shenja të sëmundjes dhe kam kryer testin ose është urdhëruar kryerja e një testi.

Kjo vlen për të gjithë personat që janë rezident në Lichtenberg, shkojnë në shkollë ose punojnë në Lichtenberg.



1. Masat e reja për karantinën në Lichtenberg

Zyra e shëndetit publik e Lichtenberg ka përpiluar të mërkurën, me 4 Nëntor 2020 një dekret të përgjithshëm, i cili rregullon masat e reja të karantinës për banoret dhe banorët e Lichtenberg. Këtu gjeni [dekretin](#) e ri.

2. Pikat më të rëndësishme:

- Dekreti i përgjithshëm është juridikisht i detyrueshëm për tu zbatuar.
- Për urdhërimin e karantinës ose izolimit në shtëpi nuk duhet të prisni zyrën e shëndetit publik.
- Personat e testuar si pozitiv me Corona-Virus janë të detyruar, që të futen menjëherë në karantinë ose në izolim në shtëpi. Ato nuk janë të detyruar të presin urdhrin e zyrës së shëndetit publik. Ato përgatisin vetë një listë kontaktesh me personat e kontaktit të kategorisë I dhe ja transmetojnë atë zyrës së shëndetit publik. Përveç kësaj ato informojnë kontaktet e tyre mbi rezultatin pozitiv.
- Personat, të cilët presin rezultatin e një testi të urdhëruar (klinika mjekësore ose zyra e shëndetit publik) dhe që kanë simptoma të sëmundjes, janë të detyruar që të izolojnë, si fillim edhe pa njoftim nga zyra e shëndetit publik. Ato informojnë gjithashtu personat e tyre të kontaktit.
- Personat e kontaktit të kategorisë I janë të detyruar të izolojnë, edhe pa njoftim nga zyra e shëndetit publik.
- Mesazhi më i rëndësishëm është: reduktoni si fillim në përgjithësi kontaktet tuaja!

3. Rregullat e sjelljes – Pyetjet që bëhen shpesh

3.1. Çfarë duhet të bëj, gjatë kohës që pres rezultatin e testit tim?

Nëse keni shenja dhe simptoma të sëmundjes **dhe** është bërë testi i coronas me urdhër të zyrës së shëndetit publik ose të një mjekeje/mjeku, ekziston dyshimi që ju jeni i infektuar. **Ju duhet të futeni menjëherë në karantinë.** Ju nuk duhet të prisni njëherë për një njoftim të zyrës së shëndetit publik. Karantina juaj në një rast të tillë përfundon, nëse posedoni një rezultat negativ të testit.

Ju lutemi informoni, ndërkohë që prisni rezultatin e testit, **me telefon ose me shkrim** të gjithë personat, me të cilët ju keni pasur kontakt në dy ditë parë shenjave tuaja të para të sëmundjes (personat e kontaktit të kategorisë I)

Përcaktimi i kategorive të kontakteve të riskut të RKI.

Këto persona duhet ti kushtojnë vëmendje shenjave të sëmundjes dhe të reduktojnë shumë kontaktin me persona të tjerë. Këto persona nuk duhet të futen ende në karantinë në këtë moment kohor.

Nëse rezultati i testit është pozitiv, karantina juaj zgjatet.

Se si duhet të silleni gjatë karantinës e mësoni këtu **FLYER I RKI-Karantina**

3.2. Testi im është pozitiv, çfarë duhet të bëj?

A. Ju jeni i detyruar që të futeni **menjëherë** në karantinë ose të qëndroni në karantinë. Në karantinë ju jeni futur, menjëherë sapo është urdhëruar që ju të kryeni një test ose testi është kryer. Mos prisni për një njoftim ose një urdhër të zyrës së shëndetit publik. Kjo e fundit do ju kontaktojë juve në një moment kohor më të mëvonshëm.

Karantinë do të thotë: Mos u largoni nga banesa juaj, përveç rastit kur duhet të merrni postën ose të nxirrni jashtë mbeturinat. Mënjanoni kontaktin e drejtpërdrejtë me personat e tjerë në familjen tuaj. Qëndroni, nëse është e mundur, në një dhomë tuajën – edhe kur konsumoni vaktet e ushqimeve. Mbani një maskë, nëse keni kontakt me persona të tjerë në familjen tuaj. Ajrosni rregullisht të gjitha dhomat dhe banesën. Nëse keni kopsht ose ballkon, mund të qëndroni atje i vetëm. Se si duhet të silleni gjatë karantinës mund ta gjeni edhe këtu **FLYER I RKI-Karantina**

Karantina përfundon 10 ditë pas fillimit të shenjave të sëmundjes, nëse ju më pas nuk keni pasur shenja të sëmundjes të paktën prej 48 orësh. Përndryshe karantina zgjatet në mënyrë automatike me 4 ditë deri sa për të paktën 48 orë të mos ekzistojnë më simptomat e sëmundjes.

B. Përpiloni një listë kontaktesh. Shkruani të gjithë kontaktet tuaja të ngushta me emër, adresë, ditëlindje, numër telefoni dhe adresë E-Mail-i, me të cilët keni pasur

kontakt në dy ditët para fillimit të shenjave të para të sëmundjes. Pasi kontaktet tuaja të ngushta mund të jenë gjithashtu të infektuar. Për orientim: Kontaktet e ngushta janë personat, të cilët ju i keni takuar në ambiente të mbyllura për një kohë më të gjatë se 15 minuta pa maskë dhe me një distancë nën 1,5 metra. Në rastin e këtyre personave kemi të bëjmë me „persona kontakti të kategorisë I“ **Përcaktimi i kategorive të kontakteve të riskut të RKI** . Dërgojani këtë listë zyrës së shëndetit publik corona@lichtenberg.berlin.de

C. Informoni personat tuaj të kontaktit I. Informoni kontaktet tuaja të ngushta (personat e kontaktit të kategorisë I) **Përcaktimi i kategorive të kontakteve të riskut të RKI** ., që ju duhet të futeni menjëherë në karantinë dhe që ky informacion nga ana juaj është i detyrueshëm. Këto persona kontakti do të marrin nga zyra e shëndetit publik, në një moment kohor më të mëvonshëm, një njoftim si dhe një vërtetim për punëdhënësin ose shkollën, me postë ose me E-Mail. **Personat e kontaktuar nuk presin njoftimin e zyrës së shëndetit publik, por reagojnë pas telefonatës tuaj.**

Karantina përfundon 14 ditë pas kontaktit të ngushtë të fundit me ju, nëse të paktën për 48 orë nuk janë shfaqur më simptoma. Se si duhet të silleni gjatë karantinës e mësoni këtu **FLYER I RKI-Karantina**

3.3. Kush është person kontakti I?

Kontaktet e ngushta ose personat e kontaktit I janë personat, të cilët kanë takuar personat e testuar pozitiv me corona në ambiente të mbyllura për një kohë më të gjatë se 15 minuta pa maskë dhe me një distancë nën 1,5 metra. Në rastin e këtyre personave kemi të bëjmë me „Persona kontakti I“ **Përcaktimi i kategorive të kontakteve të riskut të RKI** .

3.4. Si sillem unë si person kontakti I

Ju jeni i detyruar të futeni menjëherë në karantinë! Eventualisht ju nuk do ta merrni këtë informacion në mënyrë të drejtpërdrejtë nga zyra e shëndetit publik ose klinika juaj mjekësore, por nëpërmjet palëve të treta (p.sh. nga personi i infektuar, punëdhënësi ose nga drejtorja e shkollës). Megjithatë ky informacion është i detyrueshëm. Ju nuk lejoheni të largoheni nga banesa juaj dhe duhet të evitoni kontaktin me personat e tjerë në familjen tuaj. Testi nëse e keni virusin është i nevojshëm vetëm atëherë, nëse ju vetë keni shenja të sëmundjes si ethe, kollë ose dhimbje fyti etj.. Në këtë rast ju lutemi telefonin menjëherë zyrën e shëndetit publik të qarkut tuaj.

Karantina përfundon për K1 pa simptoma, 14 ditë pas kontaktit të fundit të ngushtë me personin e testuar pozitiv. Edhe nëse ju keni një rezultat negativ të testit, karantina në parim **nuk** shkurtohet. Se si duhet të silleni gjatë karantinës e mësoni këtu **FLYER I RKI-Karantina**.

Nëse janë shfaqur simptoma të sëmundjes dhe nëse jeni testuar pozitiv, atëherë do të klasifikoheni si i sëmurë. Nëse është ky rasti, atëherë duhet të veproni sipas pikës "Testi im është pozitiv". Ju do të merrni nga zyra e shëndetit publik një njoftim si dhe një vërtetim për punëdhënësin ose shkollën, me postë ose me E-Mail.

- 3.5.** Një person më kontakton mua dhe me informon që ai është testuar pozitiv me corona. Ne kemi pasur kontakt të ngushtë. Çfarë duhet të bëj unë?

Hyni menjëherë në karantinë. Mos prisni për fillimin e karantinës që të kontaktoheni nga ana e zyrës së shëndetit publik. Zyra e shëndetit publik do ju kontaktojë juve në telefon në një moment më të mëvonshëm kohor. Por kjo gjë mund të zgjasë disa ditë. Ju do të merrni nga zyra e shëndetit publik një njoftim si dhe një vërtetim për punëdhënësin ose shkollën, me postë ose me E-Mail. Se si duhet të silleni gjatë karantinës e mësoni këtu [FLYER I RKI-Karantina](#) .

- 3.6.** A duhet ta respektoj unë karantinën?

Po, për të mbrojtur njerëzit që jetojnë me ju dhe edhe sepse në të kundërt ju mund të gjobiteni me një gjobë prej 25.000 Eurosh.

- 3.7.** Kompensimi / rimbursimi në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Infeksionit në rast të ndalimeve të ushtirimit të punës dhe karantinës

Nëse keni të drejtë për kompensim ose rimbursim, mund të gjeni më shumë informacione si më poshtë:

[Rimbursimi sipas Ligjit për Mbrojtjen e Infeksionit - punëdhënësit](#)

[Rimbursimi sipas Ligjit për Mbrojtjen e Infeksionit – të vetpunësuarit](#)